

Gjykata komunale për kundërvajtje në Ferizaj, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Faruk Guri nga Ferizaj, për shkak të kryerjes së veprës kundërvajtëse nga neni 17 par. 1 pika 1 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të Zyrtareve të lartë publik, e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet me datë 08.11.2012 merr këtë:

AKTVENDIM

I pandehuri: Faruk (Tahir) Guri. i lindur me datë 17.01.1959, me vendbanim në RR. Rifat Berisha nr.17 KK Ferizaj, me profesion jurist, i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse gjatë ushtrimit të funksionit publik, në pozitën këshilltar në asamblenë Komunale të KK Ferizaj, nuk e ka deklaruar pasurin brenda afatit ligjor, obligim ligjor që parashihet sipas Ligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publik,
-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 17 par.1 pika 1 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të Zyrtareve të lartë publik
-andaj në bazë të dispozitës së thekësuar ligjore,

DËNOHET

Me gjobë në të holla në shumë prej 1000Euro (njëmijë Euro)
Dënimin e shqiptuar duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi. Nëse i njëjti nuk e paguan në afatin e caktuar, do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh.
I pandehuri obligohet që në emer të shpenzimëve të procedurës gjyqësore, të paguaj shumën paushalle prej 10 €. në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

ARSYETIMI

Agjensioni kundër Korrupsionit në Prishtinë i parashitri kësaj Gjykate, kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje nr.01-2207/2012 datës 04.06.2012, kundër të pandehurit Faruk Guri nga Ferizaj – Këshilltar në KK Ferizaj, për shkak se nuk ka përmbushur obligimin ligjor që parashihet me Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të lartë Publik, dhe kërkoi që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet konform nenit 17 par.1.3 të Këtij Ligji.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e tij të dhënë me datë 01.10.2012, ka deklaruar se formularin mbi deklarin e pasurisë e ka pranuar nga zyrtaret komunal gjatë mbledhjes së Kuvendit, dhe pasi e ka plotësuar këtë formular e ka dërguar me postë në Agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë, mirëpo nuk i kujtohet data kur e ka dërguar, dhe si dëshmi se e ka dorëzuar formularin për deklarin e pasurisë, ka ofruar si provë materiale Kërkesen për përmirësimin e të dhënave të formularit dt.24.09.2012 nga Agjensia kundër Korrupsionit.

Për të vërtetuar gjendjen faktike dhe të plotë, gjyqtari e ftoi të dëshmoi zyrtarin Naser Musa – në pozitën e zyrtarit të pikës kontaktuese në KK Ferizaj, me dt. 02.10.2012, i cili deklaroi se materialin e formularëve për deklarin e pasurisë iu ka shpërndarë këshilltarëve të asambleve komunale në mbledhjen e dt.09.03.2012, të cilët janë njoftuar edhe gojarisht nga foltorja e sallës së kuvendit nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, dhe për këtë si dëshmi ofron regjistrin e anëtareve pjesëmarrës të datës 09.03.2012.

DPK/DMP

02

03-4384/12

07-12-2012

... Fatmir Matoshi – ne pozitën e mbarvajtësit të Kuvendit në dëshminë e tij të dhënë me datë 31.10.2012, deklaroi se me datë 09.03.2012, kur është mbajtur mbledhja e seancës së Kuvendit, i ka shpërndarë formularët e deklarimit të pasurisë në ulësenë e secilit këshilltar, para fillimit të seancës, dhe shton se këshilltari Faruk Guri ka qenë prezent në këtë mbledhje.

Në bazë të kërkesës së parashtruesit për fillimin e procedurës kundërvajtëse dt. 04.06.2012, deklarates së pandehurit, deklarates së dëshmitarëve, regjistri i mbledhjes KK Ferizaj dt.09.03.2012, gjyqtari pas administrimit të secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku, vërtetoi gjendjen e plote dhe faktike me çka erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e kryerjes së kundërvajtjes nga neni 17 par.1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të Zyrtareve të lartë publik, dhe i njëjti u shpall përgjegjës për kryerjen e kësaj veprë kundërvajtëse.

Këtë gjendje faktike të cekur si më lartë gjyqtari e mbështeti në shkresat e lëndës, nga të cilat vërtetohet se i pandehuri nuk ka ndërmarr asnjë veprim me të cilën do të dëshmonte përmbushjen e obligimit ligjor për ta deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor që parashihet sipas dispozitave ligjore të nenit 8 par.1 të Ligjit mbi deklarimin dhe Prejardhjen e pasurisë nr.04/L-050. Prandaj gjyqtari nuk ka mundur ta marrë në konsideratë shkresën zyrtare –Kërkesën për përmirësimin e të dhënave nga AKK dt.24.09.2012, si argument se i pandehuri e ka dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë brenda afatit ligjor, pasi që kjo shkresë i takon periudhës kohore pasi ka skaduar afati ligjor për deklarimin e pasurisë (01 Mars deri 31 Mars 2012), dhe i pandehuri nuk ka qenë në gjendje të sigurojë asnjë provë konkrete për të dëshmuar datën kur e ka bërë deklarimin e pasurisë.

Për të vërtetuar përgjegjësinë e të pandehurit në kryerjen e veprës kundërvajtëse, gjyqtari vërtetoi se nga regjistri i pjesëmarrësve në mbledhjen e KK Ferizaj të datës 09.03.2012, shihet se në numrin rendor 31, figuron emri dhe nënshkrimi i të pandehurit, ndërsa nga deklarata e dëshmitarëve Naser Musa – zyrtar i pikës kontaktuese në KK Ferizaj, dhe Fatmir Matoshi zyrtar për mbarëvajtjen e Kuvendit, vërtetohet se i pandehuri ka marrë pjesë në mbledhjen e dt.09.03.2012 dhe të njëjtit i është dhënë materiali për deklarimin e pasurisë sikurse të gjithë pjesëmarrësve tjerë, dhe në të njëjtën kohë është njoftuar gojariht nga kryesuesi i kuvendit për plotësimin e formularit për deklarimin të pasurisë dhe të dorzojnë në Agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë.

Pas procedimit të gjitha këtyre fakteve të cekura si më lartë, gjyqtari ka fituar bindjen e lirë se i pandehuri është përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes nga neni 17 par.1 pika 1.1 të Ligjit mbi Deklarimin, Prejardhjen e pasurisë. Gjyqtari ka kualifikuar veprën kundërvajtëse të kryer nga i pandehuri, sipas dispozitave ligjore të cekura si më lartë, pasi që në këtë periudhë kohore të deklarimit të pasurisë, zyrtarët e lartë publik kanë pasur obligim ligjor ta bëjnë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë, brenda afatit të caktuar kohor.

Gjatë matjes së dënimit është marrë parasysh pesha e kundërvajtjes dhe pasojat e tyre, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, andaj të pandehurit iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 dite, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate, pa pagesë takse

Sek, juridike
M. Qalaj

